

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ATOMIC GAMING” SHPK.

Sot, në Tiranë, më 20.10.2022, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tonë të lirë, jemi shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklarojmë se kemi përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **“ATOMIC GAMING.” SHPK.**

1. Unë ortaku Tafil Buçesi lindur më 19-07-1995, në Dushk dhe banues në Yzberisht, Tiranë në adresën: Rruga Kadri Roshi, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin Nr. 035273780 dhe me numër personal J50719032G, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Unë ortaku Migen Ipeku, lindur më 20-08-1994, në Elbasan dhe banues në Elbasan në adresën: Fushë Mbret, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin Nr. 037464238 dhe me numër personal J40820108A madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare “ATOMIC GAMING” SHPK, e cila do të nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare “ATOMIC GAMING” SHPK do të jetë në adresën: Rruga “Panojot Pano”, Pallati LLK, Kati I, Nr. pasurisë 368/16-N27, Zona Kadastrale 3866.

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit. Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt: **Organizimi dhe publikimi i lojrave kompjuterike për fëmijë. Bar – Kafe.**

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (Dhjetëmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në

emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "ATOMIC GAMING" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z.Tafil Buqesi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "ATOMIC GAMING" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "ATOMIC GAMING" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.


THEMELUESIT E SHOQËRISË TREGTARE

"ATOMIC GAMING" SHPK

ORTAKU


.....


ORTAKU


.....
